



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

**KEC**

Qendra për Arsim e Kosovës  
Kompleksi i Shkollës "Mileniumi i Tretë",  
Rr. Isa Kastrati", p.n. 10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel./Fax +381-38-244 257  
E-mail: [office@kec-ks.org](mailto:office@kec-ks.org) ; [www.kec-ks.org](http://www.kec-ks.org)



**United Nations Children's Fund**  
Ali Pashë Tepelena, No. 1  
Prishtina, Kosovo Office  
Telephone: +381 38 249 230/231/232  
Facsimile: +381 38 249 234  
[prishtina@unicef.org](mailto:prishtina@unicef.org)  
[www.unicef.org/kosovo](http://www.unicef.org/kosovo)

## **RAPORT NARRATIV**

### **PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT KRIJIMI I MJEDISEVE JO TË DHUNSHME DHE MIQËSORE/ HUMANE NË SHOQËRI DHE SHKOLLA PËR PERIDHËN SHTATOR - DHJETOR 2008**

**RAPORTUES: HALIM HYSENI**



**PRISHTINË , DHJETOR 2008**

## 1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

**Raporti ka për qëllim të bëjë një përmbledhje të realizimit aktivitetëve të parapara me projektin: Krijimi i mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe miqësore/ humane në shoqëri dhe shkolla , të cilin e financon UNICIF.**

**Me projekt gjatë periudhës shtator - dhjetor 2008 , është paraparë që gjatë të realizohen këtë veprimtari:**

1. Të zhvillohet një punëtori në të cilën do të prezantohen gjendja e sigurisë, shkalla dhe etiologjia e dhunës në shoqëri dhe shkolla në vendet e rajonit si dhe të mblidhen informacione për strategjitë e mundshme veprimi për krijimin mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe miqësore /humane në shoqëri dhe shkolla
2. Të përgatitet një Doracak për punën e Komiteteve Shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
3. Të zhvillohen një hulumtim i shpejtë për të vlerësuar gjendjen e të drejtave të fëmijës në arsimin fillorë dhe të mesëm të Kosovës
4. Të përgatitet dhe të organizohet në panair për të Drejtat e Fëmijës në Kosovë, për të shënuar: Ditën Ndërkombëtare të Drejtave të Fëmijës dhe për të sensibilizuar opinionin si dhe për të promovuar punën dhe arritjet e institucioneve të Kosovës , të shoqërisë civile dhe të organizatave qeveritare dhe jo- qeveritare vendore dhe ndërkombëtare në fushën mbrojtjes dhe të promovimit të drejtave të njeriut
5. Të organizohen dy tryeza të rumbullakëta me qëllim të vetëdijesimit të shoqërisë për rolin dhe rëndësinë që kanë mjediset e sigurta, jo të dhunshme dhe miqësore/ humane për shoqërinë dhe shkollat e Kosovës

Të gjitha këto aktivitete janë realizuar në tërësi. Realizimi i këtyre aktiviteteve është mbuluar nga mjetet e informacionit. Zbatimi i këtyre aktiviteteve ka krijuar një bazë të shkëlqyer për rritjen e vetëdijes në shoqërinë kosovare për rolin dhe rëndësinë që kanë mjediset e sigurta dhe jo të dhunshme për zhvillimin e plotë të personaliteti të fëmijëve në pajtim me nenet 29 dhe 30 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të ,

për demokratizimin e shoqërisë kosovare, sundimin e ligjit dhe të shtetit ligjor; si dhe vendosjen e fëmijës/ njeriut në qendër, për të krijuar në shoqëri miqësore dhe kohezive në parimin e përgjegjësisë qytetare, në përputhje me shkathtësitë e shekullit XXI dhe të Objektivave të Zhvillimit në Mileniumit e Tretë .

## 2. ORGANIZIMI I PUNËTORISË NË TEMËN : KRIJIMI I MJEDISEVE TË SIGURTA, JO TË DHUNSHME DHE HUMANE NË SHOQËRI DHE SHKOLLA

Punëtorja është mbajtur nga data 14 – 17 tetor 2007. Ka zgjatë dy ditë të plota .

Në punëtori kanë marrë pjesë 33 pjesëmarrës të profileve të ndryshme( punëtor arsimit, veprimtarë për të drejtat njeriut dhe të fëmijës, punëtorë socialë, pjesëtarë të Policisë së Kosovës, juristë etj<sup>1</sup> .

Në këtë punëtori janë paraqitur disa referate në temën: Dhuna, Zgjidhja konstruktive e konflikteve; Dhuna në vendet e rajonit; projekte dhe ide për krijimin e mjediseve të sigurta dhe jo të dhunshme dhe miqësore/humane në shoqëri dhe në shkolla.

Punëtorja është zhvilluar me qëllim që të siguroje: *informacione, ide dhe mendime si dhe përvoja pozitive për aspektet e ndryshme të krijimit të mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla*

Në këtë punëtori janë prezantuar rezultatet e hulumtimeve për dhunën, sigurinë, strategjitë e mundshme për parandalimin dhunës, çështjet dhe aspekte e ndryshme për adresimin e dhunës me qëllim të parandalimit; janë dhënë ide për krijimin rrjeteve të fuqishme për mbrojtjen dhe promovimin, si dhe krijimin mjediseve miqësore për fëmijë.

Rezultatet e hulumtimeve që kishin të bënin me dhunën dhe parandalimin saj u paraqitën nga :

1. **Erlehta Mato:** *Dhuna mbi fëmijë në Shqipëri , në dritën e hulumtimeve të zhvilluara në Shqipëri*
2. **Afërdita Spahiu:** *Dhuna mbi fëmijë në Kosove dhe Kroaci në dritën e rezultateve të hulumtimit të bërë nga UNICEF*
3. **Nadezhda Shatriq:** *Dhuna mbi fëmijë në pjesën veriore të Mitrovicës*

---

<sup>1</sup> Listën e pjesëmarrësve e gjeni ne veb faqen. [www.childright-ks.org](http://www.childright-ks.org) në kuadër të Raportit Narrativ për punëtorinë mbajtur në Strugë me rekomandime.

**Zonja Erlehta Mato** mbajti edhe një prezantim të shkëlqyer për *Zgjidhjen konstruktive të konflikteve dhe ndikimi i këtyre zgjidhjeve në krijimin e mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla.*

**Ardita Kabashi Hima**, bëri prezantim të Projektit : *Krijimi i mjediseve të sigurta jo të dhunshme dhe miqësore/ humane në shoqëri dhe shkolla i cili zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës dhe që financohet nga UNICEF*

**Halim Hyseni** , beri prezantimin e *Kornizës së Programit për krijimin e mjedisit të sigurt jo të- dhunshëm dhe miqësor/ human në shoqëri dhe në shkolla.* Fjala është për një koncept inicial për hartimin e një strategjie nacionale të veprimit afatgjatë.

Nga puna në grupe janë siguruar informacione shumë të dobishme të cilat do të gjejnë zbatim në planin nacional.

Nga kjo punëtori kanë dalë në mori përfundimesh dhe rekomandimesh ( 21 - shiko raportin : burimi : fusnota 1. e këtij Raporti<sup>2</sup>) të cilat do të realizohen paralelisht me zbatimin e këtij Projekti., me të cilin objektivisht synojmë ndryshime të rëndësishme në krijimin e mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe miqësore/humane në shoqëri dhe shkolla.

Të gjitha rekomandimet dhe përfundimet e Punëtorisë i kemi përmbledhur në këto tetë pika:



<sup>2</sup> Shih Raportin: . [www.childright-ks.org](http://www.childright-ks.org)

1. Një qasje aktive ndërveprimi me vendet e rajonit dhe Bashkësinë Ndërkombëtare për të krijuar mjedis të përshtatshëm rajonal i cili do të angazhohet për paqe aktive të bazuar në bashkëpunim dhe ndërveprim, në besim dhe miqësi ndërmjet popujve

2. Me të gjitha vendet e rajonit( ndoshta është mirë UNICEF dhe MASHT-i i Kosovës në Prishtinë të marrin një nismë të këtillë) duhet t' shikojnë sistemet e tyre arsimore dhe të bëjnë reforma kurrikulare për të evituar nga ato paragjykimet dhe stereotipat etnik, "izmat" e ndryshëm duke forcuar edukimin për të drejtat e njeriut dhe fëmijës. Në këtë kontekst do të duhej të shikoheshin kurrikulat dhe tekstet në lëndët shoqërore sidomos tekstet e letërsisë, të historisë, të gjeografisë etj. Binjakëzimi i shkollave me vendet e rajonit është me rëndësi të madhe.

3. Duhet marrë masa urgjente për përmirësimin e gjendjes sociale dhe shëndetësore në Kosove, sepse varfëria si dhunë strukturore paraqet një problem të madh e cila jo vetëm që rrezikon sigurinë por pamundëson krijimin e mjediseve të sigurt dhe jo të dhunshme( hapja e kuzhinave për nxënës si dhe zhvillimin e ndërmarrësisë në shkolla do të ketë efekte tjera anësore pozitive do të ndalet braktisja e shkollimit, puna e fëmijëve e cila dëmton shëndetin e tyre, do të rritet cilësia e sistemit të arsimit dhe me lehtë do të realizohen shkathtësitë e shekullit XXI)

4. Me qëllim të krijimit të mjediseve të sigurt duhet të bëhet një edukim për zbatimin dhe respektimin e ligjeve, si dhe do të duhet të bëhet një mbikëqyrje rigoroze e zbatimit të ligjeve ekzistuese, para të cilave ligje të gjithë qytetarët do të duhej të jenë të barabart.

5. Në Kosovë shumë shpejtë duhet të zgjidhet ombuds- personi dhe të krijohen kushte për një caktimin e një ombuds-person të veçantë për fëmijë si dhe të nxirret një ligj i veçantë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

6. Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë do të duhet të bëjë ndryshime të mëdha në sistemin e arsimit duke krijuar standarde të avancuara të arritjeve dhe të përmbajtjeve të ndërlidhura me shkathtësitë shekullit XXI , me Objektivat e Zhvillimit të Mileniumit të Tretë, të organizojë monitorime dhe vlerësime të pavarura të efikasiteti dhe të efektiviteti të sistemi të arsimit.

7. Mediat kanë rol dhe ndikim të madh në krijimin e mjediseve të sigurta. Dhuna në institucione arsimore nxitet edhe nga dhuna e shfaqur në internet, në programet TV. , në media . Për këtë arsye mjetet e informacionit do të duhet të zhvillonin politika me të cilat do të specializonin gazetarë për përcjelljen e arsimit. Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë në bashkëpunim me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare do të duhej të organizonin trajnime për gazetarë.

8. MASHT dhe Qeveria në bashkëpunim me EULEX-in OSBE, Shoqërinë civile duhet të krijojnë një platformë për integrimin e bashkësisë etnike serbe në sistemin e integruar të arsimit të Kosovës

### **3. PUBLIKIMI I DORACAKUT/ UDHËZIMIT PËR PUNËN E KOMITETEVE SHKOLLORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS**

Qendra për Arsim e Kosovës në kuadër të projektit : Edukimi për të Drejta e fëmijës, në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë ka formuar rreth 500 Komitete shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Në këto komitete janë përfshirë mbi 9000 fëmijë nga klasa e IV e shkollës fillore deri në klasën IX të shkollave të mesme të ulëta . Qëllimi kryesor i formimit të komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës ka qenë nxitja dhe stimulimi i pjesëmarrjes së fëmijëve në vendim- marrje në fushën mbrojtjes, respektimit dhe të promovimit të drejtave të fëmijës në Kosovë.

Në përputhje me projektin, është bërë rishikimi i Udhëzimit për punën e Komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Pas rishikimit është hartuar një manual i ri i cili është publikuar në 1000 kopje ( shih. Fig. 2)

Doracaku për punën e Komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës ka këtë përmbajtje:

1. Roli i komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
2. Çfarë është komiteti shkollor?
3. Pse formohen komitetet shkollore?
4. Çfarë e bënë të njohur komitetin shkollor?
5. Informata,informata, informata.....
6. Si të mbajmë agjendë? Për çka na nevojitet agjenda? Si përgatitet një agjendë?
7. Raportet e komitetit shkollor me këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
8. Pjesëmarrja e prindërve në komitetin shkollor
9. Mënyra e punës së komitetit shkollor
10. Atmosfera dhe relacionet në shkollë
11. Rregullat për siguri më të madhe në shkollë
12. Adresimi dh reagimi ndaj dhunës

13. Çka të bëjmë që të ndihemi të sigurt? Si të parandalojmë dhunë në shkollë dhe shoqëri? Si të krijojmë një ambient të bukur për ne?
14. Roli i shkollës në punën e komitetit shkollor
15. Intervistë me dy nxënës, anëtarë të komitetit shkollor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

Promovimi i doracakut është bërë më datën 18 dhjetor 2008, ndërsa shpërndarja dhe monitorimi zbatimi të tij do të bëhet pas promovimit. Shpërndarja e doracakut në shkollat e Kosovës do të bëhet gjatë muajit janar 2008.



**Ballina e Doracakut për punën e komitetit shkollor**

#### **4. VLERËSIMI I SHPEJTË I PUNËS SË KOMITETVE SHKOLLORE GJENDJES SIGURISË NË INTITUCIONET ARSIMORE DHE GJENDJES SË DREJTAVE TË FËMIJËS**

Më qëllim të avancimit të sigurisë, parandalimit të dhunës mbi fëmijë dhe krijimit të mjediseve të miqësore /humane për fëmijë me projekt është paraparë që të sigurohet një informacion i shpejtë për gjendjen e sigurisë në shkolla , për shkallën e përdorimit të dhunës në institucionet e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët në Kosovë.

Për këtë qëllim janë realizuar këto aktivitete:

- a. është hartuar projekti i hulumtimit me instrumentet përkatëse;
- b. është formuar ekipi hulumtues në përbërje: Halim Hyseni , udhëheqësi i ekipit hulumtuese, Gabrielle Arietano, Ardita Kabashi Hima dhe Petrit Tahiri;
- c. janë identifikuar 213 shkolla në të cilat është realizuar hulumtimi
- d. hulumtimi është zhvilluar gjatë muajit tetor 2008
- e. Futja e të dhënave në programin SPSS është bërë gjatë muajit nëntor
- f. Analiza statistikore është bërë gjatë muajit nëntor
- g. Hartimi i raportit është bërë gjatë muajit nëntor

Projekti i hulumtimit është hartuar gjatë muajit shtator. Projekti përmban:

1. Në vend të fjalës hyrëse- pak fjalë për gjendjen të drejtave të fëmijës në Kosovë- sot
2. Pasojat e shkeljes së drejtave të fëmijës për Kosovën
3. Qëllimi i hulumtimit
4. Objektivat e hulumtimit
5. Kampioni
6. Teknikat e hulumtimit
7. Metodrat e hulumtimit
8. Instrumentet e hulumtimit

## 9. Hipotezat e hulumtimit

## 10. Organizimi i hulumtimit

Në hulumtim me qëllim të vlerësimit funksionimit të komiteteve shkollore për mbrojtjeje të drejtave të fëmijës në 21 komuna janë përfshirë gjithsej 183 shkolla në të cilat mësimi zhvillohet në pesë gjuhë mësimore: shqipe, serbe, boshnjake, turke, dhe kroate. Numri i shkollave të përfshira paraqitet në T-1.

Në këtë hulumtim kemi dashur të konstatojmë shkallën e funksionimit të komiteteve shkollore dhe angazhimin e këshilltarëve për të drejta e fëmijës në mbrojtjen dhe funksionimin e komiteteve shkollore dhe avancimin dhe promovim e të drejtave të fëmijës.

Në hulumtimi kemi konstatuar se në asnjë shkollë në të cilën mësimi zhvillohet në gjuhën serbe nuk janë themeluar komitete shkollore. Shkollat e përfshira në hulumtim që lidhen me komitete shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijë janë: 1. “ Vuk Karaxhiq” në Fushë Kosovë; 2. Shkolla në Uglar në Fushë Kosovë; 3. Shkolla “Aca Maroviq “ në Fushë Kosovë; 4. ”Dositej Obradoviq” në Palaj - Obiliq; 5. “Milan Rajkiq” në Bajmovic; 6. “Sveti Sava” në Plemetin; 7. Branko Radiqeviq” në Obiliq 8. “Svetozar Markoviq” Hoqë e Madhe; 9.”Vuk Karaxhiq” Rahovec ; 10. “Sveti sava “ në Kllokot; 11. “Marko Rajkoviq” Mogillë ;12. “Mladen Markoviq’ në Viti



Moment nga hulumtimi i shpejtë: Nxënësit plotësojnë pyetëSORIN

**T-1. PASQYRA TABELARE E KOMUNAVE , SHKOLLAVE, KOMITETVE DHE TË KËSHLILLTARËVE PËR TË DREJTAT E FËMIJËS**

Nr.	Emërtimi i komunës	Numri i shkollave	Nr. i KSH që funksionojnë			Nr. KSH që nuk funksionojnë			Numri i këshilltarëve për të drejtat e fëmijës		
			Qytet	Fshat	Gjiths.	Qytet	Fshat	Gjiths.	Qytet	Fshat	Gjih.
1.	Artanë-Novobërdë	5	1	0	1	0	4	4	2		2
2.	Deçan	18	1	13	14	0	4	4	13	19	32
3.	Dragash- Sharr	2	-	2	2	-	-		-	12	12
4.	Ferizaj	20	4	4	8	1	11	12	7	4	11
5.	Fushë Kosovë	5	0	-	0	5	-	5	0	-	0
6	Gjakovë	5	3	-	3	2	-	2	29	-	29
7.	Gjilan	12	6	5	11	0	1	1	27	10	37
8.	Istog - Burim	2	2	-	2	0	-	0	6	0	6
9.	Kaçanik	2	2	-	2	0	-	0	5	-	5
10.	Kamenicë- Dardanë	5	0	4	4	1	-	1	0	9	9
11.	Klinë	2	1	1	2	0	-	0	2	5	7
12.	Lypjan	1	0	-	0	1	-	1	3	-	3
13.	Mitrovicë	20	6	6	12	3	5	8	14	19	33

14.	Obiliq - Kastriot	7	0	1	1	3	3	6	0	2	2
15.	Pejë	13	5	7	12	0	1	1	28	19	47
16.	Podujevë	17	2	9	11	1	5	6	16	27	43
17.	Prishtinë	12	10	-	10	2	-	2	34	-	34
18.	Prizren	14	4	5	9	4	1	5	32	27	59
19.	Rahovec	2	0	0	0	1	1	2	0	0	0
20.	Therandë-Suharekë	4	4	-	4	0	-	0	17	-	17
21.	Viti	15	1	4	5	0	10	10	5	10	15
	<b>Gjithsej</b>	<b>183</b>	<b>52</b>	<b>61</b>	<b>113</b>	<b>24</b>	<b>46</b>	<b>70</b>	<b>225</b>	<b>163</b>	<b>403</b>


Nga T- 1 mund të konstatohet se nga 183 shkolla sa kanë qenë objekt hulumtimi me qëllim të vlerësimit të shkallës së funksionimit të komiteteve shkollore në 113 apo 61.75% të shkollave funksionojnë komitetet shkollore dhe në 70 shkolla apo 38.25% nuk funksionojnë komitetet shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Nga T-1 po ashtu, shihet qartë se shkalla më e madhe mosfunksionimit të komiteteve shkollore është shkollat rurale në të cilat prej gjithsej 107 shkollave të përfshira në hulumtim, vetëm në 61 shkollë apo 57.01% funksionojnë komitete shkollore dhe në 46 shkolla apo 42.99% nuk funksionojnë komitete shkollore.

Përqindja e funksionit të komiteteve shkollore në shkollat urbane është shumë me lartë sepse prej 76 shkollave të përfshira në hulumtim në 52 apo 68.42% të shkollave funksionojnë komitete shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe në 24 apo 31.58% nuk funksionojnë komitete shkollore .

Ky vlerësim i shpejtë tregon se para krijimit të një rrjeti mbrojtës për parandalimin e dhunës duhet inkurajuar formimin komiteteve shkollore në shkollat në të cilat këto komitet nuk funksionojnë. Shkalla e funksionimit të komiteteve shkollore paraqitet në grafikun 1

### Gr.1. Përqindja e funksionimit të komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në shkollat e Kosovës




Me qëllim të vlerësimit të gjendjes së drejtave të fëmijës, sigurisë në shkollë dhe përdorimit të dhunës në hulumtim janë përfshirë gjithsej 2004 nxënës -respondentë e sipas moshës paraqiten në T - 2.

**T-2. Frekuenca e respondentëve të përfshirë sipas moshës**

Mosha	Frekuenca ( <i>f</i> )	Përqindja	Frekuenca kumulative <i>fc</i>
12	8	3.9	3.9
13	81	39.7	43.6
14	73	35.8	79.4
15	42	20.6	100.0
Totali	204	100	

Siç mund të konstatohet se numri më i madh i fëmijëve ka qenë i moshës 13 vjeçare. Kjo më qartë shihet nga grafikun nr.2


**Gr.2. Përqindja e fëmijëve të përfshirë në hulumtim sipas moshës**



Strukturën e fëmijëve të përfshirë në hulumtim e paraqesim në grafik 3.

### Gr.3. Struktura gjinore e fëmijëve të përfshirë në hulumtim

Në hulumtim 9.3 % e fëmijëve kanë frikë nga



Në pyetjen: “Kur vini në shkollë, a keni frikë” nga 187 nxënës sa janë përgjigjur në këtë pyetje 19 apo 9.3 % prej kanë deklaruar se kanë frikë.. Fëmijët e përfshirë në hulumtimin kanë deklaruar se më së shumti frikë kanë nga huliganët ( 56%) dhe mësimdhënësit 4 %

Ajo që shqetëson është se nga 204 nxënës të anketuar 101 apo 49.5% nuk janë të kënaqur me higjienën në shkollë.

Nga 103 nxënës që janë përgjigjur në pyetjen a është përdorë dhuna fizike ndaj jush, 34 apo 16.4 % kanë deklaruar se ndaj tyre përdoret dhuna fizike. . Përkatësisht rënia e përdorimit të dhunës fizike mbi nxënës që nga viti 2003 është zvogëluar vetëm për 1.2 %<sup>3</sup>

Sipas nxënësve të anketuar më së shumti dhunë fizike ndaj tyre kanë përdorë dhe përdorin shokët 10.8% mësimdhënësit (5.9% ) dhe pas tyre menjëherë vijnë moshatarët e tyre ( 4%) Fëmijët vazhdojnë të përqeshen nga mësimdhënësit e tyre duke i fyer me fjalë përçmuese:viç, trullavicë, rrugaç, i pamoralshëm, psikopat, pis i poshtër; babin e ke çoban, mshele, çka po i hap sytë si dreq, debil, nuk je në striptiz, magar,

<sup>3</sup> Shih më gjerësisht: Të drejta e fëmijëve në sytë e nxënësve kosovarë , KEC, 2004, f. 85 .-89

*gomar, , hajvan, manjak idiot, lopë budalla, leshkuq, qorr, lapericë llafazane, kryemadh, llapoç, kriminel, psikopat, kafshë , idiot dreq*

Këto fjale fyese përdoren gjatë gjithë kohës edhe pse gjatë këtyre viteve janë bërë shumë përpjekje për të parandaluar dhunën orale mbi fëmijë

Ajo që shqetëson është se çdo i pesti nxënës nuk është i kënaqur me punën e mësimdhënësve

Një pyetje ka qenë e shtruar lidhur me funksionimin e komiteteve shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Nga 204 nxënës 88 apo 43.1 % i fëmijëve nuk kanë dëgjuar kanë për punën Komitete shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës

Fëmijët kanë deklaruar se më së shumti besim për mbrojtjen kanë te kujdestari i klasës 38,7 dhe te drejtori i shkollës po ashtu 38.7%

Me qëllim të konstatimit të gjendjes së drejtave të fëmijës në projekt është paraparë që të intervistohen mësimdhënës. Për këtë qëllim në hulumtim janë përfshirë 82 mësimdhënës, nga të cilat 62 ose 75.6 % kanë qenë të gjinisë femërore dhe 20 apo 24.6% të gjinisë mashkullore. Nga aspekti i përgatitjes shkollore 48 apo 58.5 kanë qenë me shkollë të lartë pedagogjike, 17 apo 20.7 kanë qenë me fakultete akademike katërvjeçare, 5 apo 6.1 % kanë qenë me shkollë të mesme , 6 apo 7.3 me Fakultet të Edukimit dhe dy apo 2.4% nuk e kanë paraqitur përgatitjen shkollore.

Gjatë këtij vlerësimi kemi konstatuar 45 mësimdhënës apo 54.9 % punën e komiteteve shkollore e vlerësojnë si të shkëlqyeshme, 15 apo 18.3 % si shumë të mirë , pesë mësimdhënës apo 6.1 % e vlerësojnë si të mirë, 2 ose 2.4 % e vlerësojnë si të kënaqshme dhe 11 apo 13.4 % si të dobët.

Është shumë interesant vlerësimi i punës së këshilltarëve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, puna e të cilëve vlerësohet shumë lartë. Kështu, p.sh. 45 apo 54.9 % të mësimdhënësve punë e këshilltarëve e vlerësojnë si të shkëlqyer; 10 apo 12.2% e vlerësojnë si shumë të mirë , 5 ose 6.1 % si të mirë ; 12 apo 14.6% si të kënaqshme dhe 6 apo 7.3 e vlerësojnë si të pamjaftueshme.

Nga ky vlerësim mund të thuhet se në krijimin e mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe miqësore për fëmijë janë dy struktura të rëndësishme me të cilat duhet llogaritur. Këto dy struktura janë komitetet shkollore për mbrojtjen e të drejtave të

fëmijës dhe këshilltarët – mësimdhënësit për mbrojtjen dhe promovimin të drejtave të fëmijës. Strukturat e këtilla janë adresat e vërteta dhe reale me të cilat duhet punuar për parandalimin dhe adresimin dhunës , si dhe për krijimin mjediseve miqësore dhe humane për fëmijë

Në pyetjen e parashtruar në pyetësor: Çfarë duhet bërë që të avancohet puna e komiteteve shkollore për mbrojtje e të drejtave të fëmijës kemi siguruar informacione shumë interesante. Përgjigje në këto pyetje do i përdorimin në procesin e krijimit të rrjetit të fuqishëm për krijimin mjediseve të sigurta , jo të dhunshme dhe miqësore për fëmijë.

Hulumtimi tregon qartë se duhet punuar shume në krijimin mjediseve të sigurta për mbrojtjen fizike, sociale – shëndetësore higjienike, ngritjen e cilësisë së mësimdhënies etj.

## 5. ORGANIZIMI I TRYEZAVE TË RRUMBULLAKËTA

Me projekt është paraparë që gjatë një viti të organizohet 10 tryeza të rrumbullakëta debate, diskutime, debate publike në formën e kolumnave, eseve shkrimeve etj. Të gjitha këto forma organizative kanë për qëllim të rrisin shkallën e sensibilizimit të opinionit për rolin dhe rëndësinë kanë mjediset e sigurta, jo të dhunshme dhe miqësore në shkolla dhe shoqëri për zhvillimin e fëmijëve, të qytetarëve dhe të shoqërisë së Kosovës në përgjithësi.

Deri me tani janë zhvilluar 4 tryeza të rrumbullakëta. Në tryezën parë të rrumbullakët të mbajtur në 16 tetor në temën: *Roli dhe rëndësia e sigurisë juridike në krijimin mjediseve të sigurta dhe jo të dhunshme.*

Tryeza është mbajtur më 16 tetor 2008. Në të kanë marr 33 pjesëmarrës. Ishte mendim unanimit të gjithë pjesëmarrësve se Kosova ka probleme të mëdha me zbatimin ligjit dhe të ligjshmërisë. Mos respektimi i ligjeve krijon pasiguri dhe ka ndikuar shumë në rritjen e formave të ndryshme të pasigurisë. Po ashtu, në këtë tryezë ishte e konstatim se moszbatim i ligjeve ka ndikim edhe në realizimin të drejtave të njeriut dhe të fëmijës (p.sh mos sigurimi i teksteve falas për nxënësit arsimit të detyruar etj). Dy tryeza të tjera janë mbajtur me datën 10.12.2008 në pjesën veriore të Mitrovicës me mesimdhënësit që mesimin zhvillojnë në gjuhën serbe dhe me 18.12.2008 më përfaqësues të shoqërisë civile dhe të institucioneve qeveritare të Kosovës.

Në këtë tryezë është miratuar një listë e temave të cilat do të jenë pjesë e debateve, diskutimeve publike, shkrimeve me të cilat do të ndikohet në rritjen e shkallës së vetëdijesimit

Në tryezë, po ashtu u rekomandua se gjatë vitit 2009, në kurrikula shkollor të shtohen përmbajtje që kanë të bëjnë me ligjet dhe zbatimin e ligjeve në mënyrë që fëmijët të edukohen dhe të vetëdijesohen për zbatimin dhe respektimin ligjeve.

Në rekomandimin i dytë i kësaj tryeze ishte që Kuvendi i Kosovës të miratojë një Ligj të veçantë për mbrojtje të drejtave të fëmijës dhe të caktojë një ombuds - person të veçanta për fëmijë

Tryeza e dyte e rrumbullakët është mbajtur me datën 19 nëntor 2008. Tema e tryezës ishte: *Të drejtat e fëmijës në Kosovë nga këndi i një filmi të metrazhit të shkurtër*. Në debat rezultuan mendime të shumta si rreth filmit ashtu edhe rreth gjendjes së drejtave të fëmijës. Ishte mendim i të gjithëve se nevojitet të shkruhen skenarë dhe të gjirohen filma si të metrazhit të shkurtër ashtu edhe të metrazhit të gjatë në temën të drejta e fëmijës në Kosovë, siguria, parandalimi i dhunës, dhe për dhunën në përgjithësi.

Pa ashtu, pati vërejtje, sipas bindjes tonë të drejta, lidhur me politikën redaktuese të programeve televizive dhe të kinemave në të cilat shfaqen filmat me dhunë të tejskajshme që krijojnë modele të sjelljeve të dhunshme tek fëmijët.

Në debat u potencua nevoja e bashkëpunimit dhe të bashkërendimit të aktiviteteve të ndryshme për të parandaluar dhunën, për të ndihmuar viktimat për të trajtuar edhe ushtruesit e dhunës. Në këtë kontekst u kërkua që forcohen shërbimet e konsulencës në shkollë (të hapen shërbimet pedagogjike – psikologjike dhe sociale); të rritet bashkëpunimi i institucioneve arsimore me Policinë e Kosovës, Gjyqësinë, Prokurorinë.

Në tryezat e mbajtura me 10 dhe 18 dhjetor objekt trajtimi ka qenë dhuna mbi fëmijë. Në tryezën e mbajtur me 18. 12. 2008 është bërë edhe promovimi i dy librave të botuara, si dhe janë paraqitur tri raporte të hulumtimeve të zhvilluara për gjendjen e të drejtave të fëmijës

Moment nga tryeza e rrumbullakët: Siguria juridike në Kosovë dhe mjediset e sigurta dhe jo të dhunshme në shkollë dhe në shoqëri



## 6. ORGANIZIMI I PANAIRIT PËR TË DREJTAT E FËMIJËS

Për herë të parë në Kosovë, në këtë vit, për nder të 20 Nëntorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, është organizuar me sukses Panairi për të Drejtat e fëmijës i cili mëtojmë të jetë tradicional dhe nga viti i ardhshëm të ketë karakter rajonal.

Panairi ka pasur për qëllim të promovojë arritjet e deritashme në fushën e të drejtave të fëmijës; të sensibilizojë opinionin e gjerë për rolin dhe rëndësinë që ka jetësimi i Konventës Ndërkombëtare për mbrojtjen dhe provimin e të drejtave të fëmijës; të identifikojë faktorët dhe strategjitë e veprimit për krijimin mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe miqësore / humane për fëmijë, në shoqërinë dhe shkollat e Kosovës.

Në panair me pjesëmarrjen e tyre na nderuan:

1. Z. Enver Hoxhaj, Ministër i Arsimit i Shkencës dhe i Teknologjisë
2. Z. Robert Fuderich, Udhëheqës i Zyrës së UNICF-it në Prishtinë
3. Z. Habit Hajredini, Koordinator i Zyrës së Kryeministrit për Qeverisje të Mirë
4. Frode Muring, Përfaqësues i Përherëshëm i UNDP në Kosovë

Në Panair, veprimtaritë e tyre që lidhen me promovimin dhe avancimin të drejtave të fëmijës prezantuan 12 organizata dhe organe qeveritare dhe jo qeveritare:

1. Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
2. UNICEF
3. Institucioni i OMBUDSPERSONIT
4. Save the Children
5. Education for All (EFA)
6. Human Rights Center
7. Terre des Hommes
8. Care International Kosove
9. Sports Sans Frontiere

10. Balkan Sunflowers

11. Kosova Rehabilitation Center for Torture Victims


12. Qendra për Arsim e Kosovës

Në panair kanë marrë pjesë gjithsej 120 persona. Në te, pos prezantimit të publikimeve janë mbajtur edhe pesë prezantime dhe një tryezë rumbullakët

Panairi është vlerësuar pozitivisht nga ekspozuesit. Të gjithë pjesëmarrësit shprehin dëshirën për vazhdimësinë e kësaj nisme<sup>4</sup>



Moment nga Konferenca e mbajtur për të drejtat e fëmijës



Moment nga Panairi i mbajtur për të drejtat e fëmijës

<sup>4</sup> Për më shumë informacione lidhur me panairin vizito veb faqen : [www.childrights-ks.or](http://www.childrights-ks.or)